



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 139

29 tetor

2012

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 641, datë 19.9.2012	Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese në marrëveshjen e huas, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Ofrimi i shërbimeve sociale”	7799
Vendim i KM nr. 642, datë 19.9.2012	Për miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese në marrëveshjen e kredisë për zhvillim, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për financimin e projektit “Shpërndarja e shërbimeve sociale”	7802
Vendim i KM nr. 643, datë 19.9.2012	Për dhurimin e një sasie armatimi, kontribut i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për qeverinë e Republikës së Kosovës për ngritjen e Muzeut të Luftës së UÇK-së.....	7805
Vendim i KM nr. 644, datë 19.9.2012	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.3.2012, për çështjen nr. 11006/06 “Cani kundër Shqipërisë”.....	7807
Vendim i KM nr. 645, datë 19.9.2012	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.2.2012, për çështjen nr. 20134/05 “Alimuçaj kundër Shqipërisë”.....	7807
Vendim i KM nr. 646, datë 19.9.2012	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2012 – 2013.....	7808
Vendim i KM nr. 647, datë 19.9.2012	Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të një sipërfaqeje prej 371.41 m ² , në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, qendrës “PROTIK”, Tiranë.....	7815

Vendim i KM nr. 648, datë 23.5.2012	Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme, të pronës nr. 842, me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në Fier, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, e për një shtesë në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.....	7818
Vendim i KM nr. 649, datë 8.10.2012	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të pronës nr. 17/16, me emërtimin “Ish-Drejtoria e Doganës Durrës”, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 586, datë 10.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror”....	7822
Vendim i KM nr. 650, datë 8.10.2012	Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit për dhënien me qira, me çmimin 1 (një) euro, të sipërfaqes 131 659 m ² , nga e cila 71 965 m ² janë në administrim të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve, Elbasan, dhe 59 694 m ² në administrim të shoqërisë “Kombinati energjetik” sh.a. Elbasan.....	7830

VENDIM
Nr. 641, datë 19.9.2012

PËR MIRATIMIN NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE NË MARRËVESHJEN E HUAS, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR FINANCIMIN SHITESË TË PROJEKTIT “OFRIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese në marrëveshjen e huas, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Ofrimi i shërbimeve sociale”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Banka Botërore	(202) 473-1000
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim	1818 H Street N.W. Washington D.C. 20433
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim	USA
	Adresa kabllore: INTBAFRAD
	Adresa kabllore: INDEVAS

17 korrik 2012

SHT Ridvan Bode
Ministër
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

Lënda: Shqipëri: Kredia IDA nr. 3513-ALB, projekti për ofrimin e shërbimeve shoqërore, huaja IBRD nr. 7690-AL, financimi shtesë për projektin mbi ofrimin e shërbimeve shoqërore

NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN E HUAS
DHE RIALOKIMI I FONDEVE TË KREDISË DHE HUAS

Shkëlqesi,

1. Ne u referohemi: a) marrëveshjes së kredisë për zhvillimin, për projektin e emërtuar më sipër, të datës 3 korrik 2001, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), të ndryshuar (marrëveshja e kredisë); dhe b) marrëveshjes së huas për projektin e emërtuar më sipër, të datës 7 prill 2009, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) (marrëveshja e huas). Ne u referohemi dhe letrave tuaja të datës 28 mars 2012, që kërkojnë një rialokim të fondeve të kredisë dhe huas dhe ristrukturimin e aktiviteteve të ndryshme të projektit, sipas projektit të emërtuar.



2. Kam kënaqësinë t'ju informoj se IDA-ja dhe IBRD-ja i përmbushin kërkesat tuaja. Rrjedhimisht, IDA-ja dhe IBRD-ja ndryshojnë pjesën E, paragrafin 2 të grafikut 1 të marrëveshjes së huas me tekstin e mëposhtëm:

“2. Zhvillimi i SII-së dhe i Regjistrit Qendror të Kontribuesve dhe të Përfituesve (regjistri qendror) nëpërmjet dhënies së mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë:

a) digjitalizimin e plotë të regjistrave të historikut të punëve të kaluara;

b) ngritjen e një sistemi arkivor të historikut të kontributeve dhe të përfitimeve për të lehtësuar sigurimin e përfitimeve;

c) zhvillimin e një sistemi të ri raportimi për kontributet e pensioneve;

d) zhvillimin e një sistemi të integruar të programeve për menaxhimin e regjistrit qendror;

e) zhvillimin e një rrjeti teknologjik informacioni ndërmjet zyrave rajonale të SII-së, qendrës së SII-së dhe institucioneve të tjera kryesore; dhe

f) mobilitet e zyrave për zyrat e SII-së dhe regjistrin qendror.”.

3. Gjithashtu, IDA-ja dhe IBRD-ja rialokojnë fondet e kredisë së alokuar në tabelën e paragrafit 1 të pjesës A të grafikut 1 të marrëveshjes së kredisë dhe shumat e huas të alokuara në tabelën e paragrafit 2 të seksionit IV. A të grafikut 2 të marrëveshjes së huas, siç paraqiten në shtojcat 1 dhe 2 përkatësisht në këtë letër.

Me respekt,
(nënshkrimi)

Lilia Burunciuc
Zëvendësdrejtore Vendi dhe Koordinatore Rajonale
Për Europën Juglindore
Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore

Rënë dakord

Shqipëri

Nga:

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____

Shtojca 1
(Kredia IDA 3513-ALB)

Kategoria	Shuma e alokuar e kredisë (shprehur në ekuivalentin e SDR-së)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen
1. Punime		
a) Për pjesën C.1 të projektit	1.367.866.05	85 %
b) Të tjera, përveç pjesës C.1 të projektit	811.186.00	75 %
2. Mallra		
a) Për pjesën C.1 të projektit	1.196.357.29	100% e shpenzimeve të jashtme, 100% e kostos lokale (kostoja e fabrikës) dhe 85 % e shpenzimeve lokale për njësitë e tjera të prodhuara ne vend
b) Të tjera, përveç pjesës C.1 të projektit	952.303.66	
3. Shërbimet e konsulencës dhe trajnimi	2.567.976.00	100%
a) Për pjesën C.1 të projektit	70.499.00	100%
b) Të tjera, përveç pjesës C.1 të projektit	325.529.00	100%
4. Kostoja operative shtuese	608.283.00	90%
5. Të paalokuara	0	
Totali	7.900.000	

Shtojca 2
(Huaja IBRD 7690-AL)

Kategoria	Shuma huas e alokuar (shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financiar
1. Mallra dhe punime sipas pjesës E të projektit	4 518 175	80 %
2. Shërbimet e konsulentëve dhe trajnimi, sipas pjesës E të projektit	454 325	100%
3. Kostot operative shtuese sipas pjesës E.5 të projektit	15 000	100%
4. Prime për nivelin maksimal të normës së interesit dhe gamën e luhatjes së normës së interesit		Shuma e pagueshme në pajtim me seksionin 2.07 (c) të kësaj marrëveshjeje, në pajtim me seksionin 4.05 (c) të kushteve të përgjithshme
5. Tarifa fillestare	12 500	Shuma e pagueshme në pajtim me seksionin 2.03 të kësaj marrëveshjeje, në pajtim me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
Shuma totale	5 000 000	



VENDIM
Nr. 642, datë 19.9.2012

PËR MIRATIMIN NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE NË MARRËVESHJEN E KREDISË PËR ZHVILLIM, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “SHPËRNDARJA E SHËRBIMEVE SOCIALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese në marrëveshjen e kredisë për zhvillim, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për financimin e projektit “Shpërndarja e shërbimeve sociale”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Banka Botërore
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe
Zhvillim
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim

1818 H Street N.W.
Washington D.C. 20433
USA

(202) 473-1000
Adresa kabllore: INTBAFRAD
Adresa kabllore: INDEVAS

17 korrik 2012

SHT Ridvan Bode
Ministër
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

Lënda: Shqipëri: Kredia IDA Nr. 3513-ALB, projekti për ofrimin e shërbimeve shoqërore, huaja IBRD nr. 7690-AL, financimi shtesë për projektin mbi ofrimin e shërbimeve shoqërore

NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN E HUAS
DHE RIALOKIMI I FONDEVE TË KREDISË DHE HUAS

Shkëlqesi,

1. Ne u referohemi: a) marrëveshjes së kredisë për zhvillimin, për projektin e emërtuar më sipër, të datës 3 korrik 2001, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), të ndryshuar (marrëveshja e kredisë); dhe b) marrëveshjes së huas për projektin e emërtuar më sipër, të

datës 7 prill 2009, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) (marrëveshja e huas). Ne u referohemi edhe letrave tuaja të datës 28 mars 2012, që kërkojnë një rialokim të fondeve të kredisë dhe huas dhe ristrukturimin e aktiviteteve të ndryshme të projektit, sipas projektit të emërtuar.

2. Kam kënaqësinë t'ju informoj se IDA-ja dhe IBRD-ja i përmbushin kërkesat tuaja. Rrjedhimisht, IDA-ja dhe IBRD-ja ndryshojnë pjesën E, paragrafin 2 të grafikut 1 të marrëveshjes së huas me tekstin e mëposhtëm:

“2. Zhvillimi i SII-së dhe i Regjistrit Qendror të Kontribuesve dhe të Përfituesve (regjistri qendror) nëpërmjet dhënies së mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë:

a) digjitalizimin e plotë të regjistrave të historikut të punëve të kaluara;

b) ngritjen e një sistemi arkivor të historikut të kontributeve dhe përfitimeve për të lehtësuar sigurimin e përfitimeve;

c) zhvillimin e një sistemi të ri raportimi për kontributet e pensione;

d) zhvillimin e një sistemi të integruar të programeve për menaxhimin e regjistrit qendror;

e) zhvillimin e një rrjeti teknologjik informacioni ndërmjet zyrave rajonale të SII-së, qendrës së SII-së dhe institucioneve të tjera kryesore; dhe

f) mobilitet e zyrave për zyrat e SII-së dhe regjistrin qendror.”.

3. Gjithashtu, IDA-ja dhe IBRD-ja riallokojnë fondet e kredisë së alokuar në tabelën e paragrafit 1 të pjesës A të grafikut 1 të marrëveshjes së kredisë dhe shumat e huas të alokuara në tabelën e paragrafit 2 të seksionit IV.A të grafikut 2 të marrëveshjes së huas, siç paraqiten në shtojcat 1 dhe 2, përkatësisht në këtë letër.

Me respekt,

(nënshkrimi)

Lilia Burunciuc

Zëvendësdrejtore Vendi dhe Koordinatore Rajonale

Për Europën Juglindore

Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore

Rënë dakord

Shqipëri

Nga:

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____



Shtojca 1
(Kredia IDA 3513-ALB)

Kategoria	Shuma e alokuar e kredisë (shprehur në ekuivalentin e SDR-së)	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen
1. Punime		
a) Për pjesën C.1 të projektit	1.367.866.05	85 %
b) Të tjera, përveç pjesës C.1 të projektit	811.186.00	75 %
2. Mallra		
a) Për pjesën C.1 të projektit	1.196.357.29	100% e shpenzimeve të jashtme, 100% e kostos lokale (kostoja e fabrikës) dhe 85 % e shpenzimeve lokale për njësitë e tjera të prodhuara në vend
b) të tjera, përveç pjesës C.1 të projektit	952.303.66	
3. Shërbimet e konsulencës dhe trajnimi	2.567.976.00	100%
a) Për pjesën C.1 të projektit	70.499.00	100%
b) Të tjera përveç pjesës C.1 të projektit	325.529.00	100%
4. Kostoja operative shtuese	608.283.00	90%
5. Të paalokuara	0	
Totali	7.900.000	

Shtojca 2
(Huaja IBRD 7690-AL)

Kategoria	Shuma huas e alokuar (shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financiar
1. Mallra dhe punime sipas pjesës E të projektit	4 518 175	80 %
2. Shërbimet e konsulentëve dhe trajnimi, sipas pjesës E të projektit	454 325	100%
3. Kostot operative shtuese, sipas pjesës E.5 të projektit	15 000	100%
4. Prime për nivelin maksimal të normës së interesit dhe gamën e luhatjes së normës së interesit		Shuma e pagueshme në pajtim me seksionin 2.07 (c) të kësaj marrëveshjeje, në pajtim me seksionin 4.05 (c) të kushteve të përgjithshme
5. Tarifa fillestare	12 500	Shuma e pagueshme në pajtim me seksionin 2.03 të kësaj marrëveshjeje, në pajtim me seksionin 2.07 (b) të kushteve të përgjithshme
Shuma totale	5 000 000	

VENDIM
Nr. 643, datë 19.9.2012

**PËR DHURIMIN E NJË SASIE ARMATIMI, KONTRIBUT I KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
NGRITJEN E MUZEUT TË LUFTËS SË UÇK-SË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhurimin qeverisë së Republikës së Kosovës të një sasive armatimi jashtë nevojave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si kontribut i qeverisë shqiptare, me qëllim ngritjen e Muzeut të Luftës së UÇK-së.
2. Lloji dhe sasia e armatimit që do të dhurohet është sipas listës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lista Nr.1. Llojet dhe sasi të armatimit që do ti dhurohen qeverisë së Kosovës për ngritjen e Muzeut të Luftës së UÇK.

Nr.	Nr. emërt.	Emërtimi i armatimit	Sasia Copë
1	O1	Pistoletë 7.62 mm model 1954	2
2	O5	Pistoletë 26 mm shenjëdhënëse	2
3	O6	Automatik 7.62 mm model 1954	2
4	O7	Automatik 7.62 mm model 1954 me qytë metalike	2
5	O8	Automatik 7.62 mm model 1956 bajonetë thikë	2
6	08a	Automatik 7.62 mm model 1956 bajonetë shtizë	2
7	08/PN	Automatik 7.62 mm model 1956 pa bajonetë	2
8	08b	Automatik 7.62 mm model 1956 me qytë metalike	2
9	08PN	Automatik 7.62 mm 1954 ASH-79	2
10	08PN	Automatik 7.62 mm 1954 ASH-82	2
11	08PN	Automatik 7.62 mm model 1956 ASH-82	2
12	08PN	Automatik 7.62 mm model 1956 ASH-82 pa bajonetë	2
13	08PN	Automatik 7.62 mm ASH-82 bajonetë shtizë	2
14	08PN	Automatik 7.62 mm ASH-82 pa bajonetë	2
15	08PN	Automatik 7.62 mm ASH-82 me qytë metalike	2
16	08PN	Automatik 7.62 mm ASH-82 me dykëmbësh	2
17	09a	Pushkë e gjatë 7.62 mm model 1953	2
18	O10	Pushkë gjysmautomatike 7.62 mm model 56 bajonetë thikë	2
19	O10b	Pushkë gjysmautomatike 7.62 mm model 56 bajonetë shtizë	2
20	O11	Mitroloz i lehtë 7.62 mm model 1953	2
21	O12	Mitroloz i lehtë 7.62 mm model 1956	2
22	O13	Mitroloz 7.62 mm model 1958	2
23	014a	Mitroloz i rëndë 7.62 mm model 1953, 1957	4
24	016a	Mitroloz 12.7 mm kundërajror model 1954	2
25	O20	Granatahedhës i lehtë 40 mm K.T. model 1956	2
26	O23	Pushkë automatike 7.62 mm model 1963	2
27	O24	Granatahedhës i lehtë 40 mm K.T. model 1969	2
28	PN	Pistoletë nagant 7.62 mm	2
29	PN	Automatik 7.62 mm (zastava)	2
30	PN	Pushkë 7.62 mm "Zastava"	2
31	021	Mortajë 60 mm model 1963	2
32	022	Mortajë 82 mm model 1953	2
33	102	Mortajë 120 mm 1955	2
34	111a	Top 75 mm pa sprapje (me trekëmbësh) model 1956	2
35	103	Mortajë 160 mm model 1956	1
		Shuma armatim :	71
36		Aparat për zbulimin e minave	2
37		Radiolidhjet	2
38		Telefon/mobil/satelitor	2
39		Helmetë	2

VENDIM
Nr. 644, datë 19.9.2012

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 6.3.2012, PËR ÇËSHTJEN NR. 11006/06 “CANI KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 19.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.3.2012, për çështjen nr. 11006/06 “Cani kundër Shqipërisë”, në shumën 6 700 (gjashtë mijë e shtatëqind) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.
 2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave.
 3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 4. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z. Besnik Cani, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.
 5. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit z. Besnik Cani, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.
 6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 645, datë 19.9.2012

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 7.2.2012, PËR ÇËSHTJEN NR. 20134/05 “ALIMUÇAJ KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 19.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 7.2.2012, për çështjen nr. 20134/05 “Alimuçaj kundër Shqipërisë”, në shumën 8000 (tetë mijë) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.



2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit z. Vehbi Alimuçaj, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit z. Vehbi Alimuçaj, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit, brenda datës 9.10.2012.

Në rast mospagimi brenda këtij afati, mbi shumën e mësipërme, paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 646, datë 19.9.2012

PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL”, ME KOHË TË PJESSHME, PËR VITIN AKADEMIK 2012 - 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për vitin 2012 - 2013, të jenë 4 665, të ndara, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|--------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për kandidatët brenda territorit të vendit | 4 075; |
| b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, me kohë të pjesshme, për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit | 200; |
| c) Kuotat për transferimin e studimeve | 100; |
| ç) Kuotat për program të dytë studimi | 100; |
| d) Kuotat për shtetas të huaj | 50; |

- dh) Kuotat për personat që nuk shikojnë 20;
 e) Kuotat për romët dhe ballkano-egjiptianët 20;
 ë) Kuotat për ish-të përndjekurit politikë 100.

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, me kohë të pjesshme, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyrohen në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij vendimi, të cilat ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit nga: Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, pasqyrohen në tabelën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, nga Republika e Maqedonisë, nga Republika e Malit të Zi dhe nga Prefektura e Preshevës, Bujanovci dhe Medvegjës aplikojnë direkt në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Rishpërndarja e kuotave të paplotësuara kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke marrë parasysh edhe kërkesat e IAL-ve publike.

4. Kuotat e pranimeve për transferimin e studimeve të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi dhe kuotat për program të dytë studimi, të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë. Kriteret për transferim përcaktohen nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe bëhen publike paraprakisht.

5. Kuotat e pranimit për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, me kohë të pjesshme, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe ndërmjet vendeve.

6. Kuotat e pranimeve, sipas shkronjës “dh” të pikës 1 të këtij vendimi, për kandidatët me statusin e personave që nuk shikojnë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

7. Kuotat e pranimeve, sipas shkronjës “e” të pikës 1 të këtij vendimi, për romët dhe ballkano-egjiptianët, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga shoqatat kombëtare respektive të romëve dhe ballkano-egjiptianëve.

8. Kuotat e pranimeve, sipas shkronjës “ë” të pikës 1 të këtij vendimi, për ish-të përndjekurit politikë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë.

9. Çdo program studimi i ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, funksionon në vitin e parë për vitin akademik 2012 - 2013, në rast se atë e ndjekin të paktën 10 studentë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimit të kandidatëve dhe i bëjnë publike paraprakisht.

11. Tarifat e përgjithshme të shkollimit, si dhe ato për çdo kredit, për studentët që regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2012 - 2013, përcaktohen në tabelën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Pagesa e tarifës bëhet me këste të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë. Studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës, pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të programit të studimit, paguajnë vetëm tarifën për kredit të lëndëve të prapambetura.

12. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2012 - 2013, dhe që u përkasin shtresave sociale, si: persona që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë, invalidë, invalidë të punës dhe fëmijët e tyre, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijë që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve dhe ushtarakëve të rënë për shkak të detyrës, si dhe të ish-të përndjekurve politikë, paguajnë një kuotë, në masën 50% të tarifës së shkollimit.

13. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë “Master profesional”, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje ndërshtetërore është parashikuar ndryshe.



14. Studentët, që përfitojnë nga kuotat e përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, i nënshtrohen tarifës së shkollimit të programit përkatës të studimit, në të cilin do të vazhdojnë studimet.

15. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të porealizuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

16. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES (TABELA Nr.1)

